



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:107755

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05375677

C.nr.719/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.H, M.Th, B.A, S.A dhe A.H me av.V.U nga Vushtrria, kundër të paditues Komuna e Vushtrrisë, lidhur me padinë për vazhdim pune ose kompensim të pagave deri në përfundim të vitit shkollor, në pajtim me nenin 399 të LPK-së, jashtë seance, me datën 26.02.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve M.H, M.Th, B.A, S.A dhe A.H, kundër të paditues Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kanë kërkuar vazhdimin e punes ose kompensimin e pagave deri në përfundim të vitit shkollor-kalendarik në shumë të cilën kanë theksuar se do ta precizojnë në shqyrtim gjyqësor dhe shpenzime të procedures.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësit me datën 01.06.2021 pranë kësaj gjykate ka paraqitë kundër të paditues me të cilën kanë kërkuar vazhdimin e punes ose kompensimin e pagave deri në përfundim të vitit shkollor-kalendarik në shumë të cilën kanë theksuar se do ta precizojnë në shqyrtim gjyqësor dhe shpenzime të procedures.

Në padi paditësit theksojnë se kanë qenë në marrëdhënie pune primare në institucionin arsimor në Komunën e Vushtrrisë – Drejtorinë e Arsimit përkatësisht dy paditësit e parë kanë qenë të punësuar në shkollën Sh.F.M.U “M...”, paditësi i tretë ka qenë i punësuar në shkollën Sh.F.M.U “M..”, ndërsa paditësi i 4-të dhe 5-të kanë qenë të punësuar në shkollën Sh.F.M.U “A...”.

Ka theksuar se kërkesen e tyre e kanë mbështet në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe asaj të vitit 2021 në nenin 11 parashikohet se: nëse mësimdhënësi që do që do të shkojë në pension ka filluar vitin shkollor do të vazhdojë punën deri në përfundim të vitit shkollor me pagë të plotë.

Kanë shtuar se paditësi i parë ka arrit moshën e pensionimit në muajin prill 2021, paditësi i dytë në muajin janar 2020, paditësi i tretë në muajin dhjetor 2019, paditësi i katërt në muajin shkurt 2020 dhe të njëjtëve u është dashur të ju mundësohet përfundimi i vitit kalendarik shkollor, por që kjo nuk është realizuar nga e paditura ashtu që të njëjtit kanë parashtrur kërkesë tek e paditura por e njëjta nuk u ka kthyer përgjigje fare. Kanë propozuar aprovimin e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësve. Gjykata i ka dërguar padinë dhe shkresat e lëndës të paditues për përgjigje në padi, ndërsa e paditura me datën 01.12.2023 ka paraqitë përgjigje në padi përmes së cilës e ka kundërshtuar padinë e paditësit si të pa bazuar, duke propozuar refuzimin e së njëjtës.

parashihet se: Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

Në rastin konkret paditësit nuk kanë provuar se e kanë kryer punën dhe kanë kaluar kohën në punë pas pensionimit të tyre në datat e lartpërmendura.

Sic shihet edhe vet thëniet e paditësve në padi, të njëjtit pas pensionimit të tyre nuk kanë pasur marrëveshje me punëdhënësin për ta vazhduar punën e tyre pas pensionimit.

Gjithashtu gjykata vjen në përfundim se neni 67 par 1 pika 1.4 i ligjit të punës ka përcaktuar se: Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore vjen në pyetje kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

Në rastin konkret paditësit e kanë mbushur moshën e pensionimit dhe kërkesa e tyre që tu vazhdohet punësimi pas pensionimit ose të kompensohen me pagë deri në përfundim të vitit shkollor kalendarik, pa punuar, është e pa bazuar.

Gjykata vlerëson se dispozita e Kontratës Kolektive të Arsimit e cituar nga paditësit dhe atë nenin 11 të Kontratës Kolektive të Arsimit, do të vinte në shprehje vetëm në rastet kur punëdhënësi ka mungesë të theksuar të punonjësve të lamisë përkatëse dhe vetëm pas marrëveshjes paraprake dhe me pelqimin e dy palëve kontraktuale, e kjo në mbështetje me nenin 67 par 1 pika 1.4 të Ligjit të Punës.

Gjykata duke pas parasysh të lartcekurat gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar, andaj pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor konform nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së në të cilin parashihet se “Kur gjykata pasi ti arrij përgjigja në padi konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadijës atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadija,“ e lidhur me paragrafin 2 të së njëjtës dispozitë ku parashihet se: “Kërkesëpadija është e pathemelt, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni po që se çartazi është në kundërshtim me faktet e treguara në padi apo poqëse faktet mbi të cila mbështetet kërkesëpadija çartazi janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi apo me faktet që janë botërisht të ditura”, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e me qëllim të ekonomizimit të procedurës.

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 452 të LPK-së ashtu që vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta të procedurës.

Nga të lartcekurat, e pa bazuar në nenin 399 të LKP-së gjykata u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.719/21, datë: 26.02.2024

GJYQTARI

Izet Gërguri

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

